

Matthias Pfaffenbichler
Kunsthistorisches Museum Wien

*Përkrenarja dhe shpata e Gjergj Kastriotit, të quajtur Skënderbe**

Abstract

In the Imperial armory of the Kunsthistorisches Museum in Vienna are stored two objects from the sixteenth century which are commonly attributed to the Albanian hero George Castriota said Scanderbeg (1403-1468): a helmet with the inventory number A127 and a sword with the inventory number A550. The author submits a precise analysis of the two objects on the basis of a rigorous investigation performed directly on these objects. The result of his research leads to new and unexpected conclusions.

Keywords: *History of South East Europe; Art History.*

Në dhomën e armëve të Muzeut Historik të Arteve (Hofjagd- und Rüstkammer des Kunsthistorisches Museum) në Vjenë ndodhen një përkrenare dhe një shpatë të cilat që nga shekulli i 16-të njihen si të heroit shqiptar Gjergj Kastrioti, të quajtur Skënderbe (rreth 1403-1468). Shtrohet pyetja se sa i saktë është një pohim i tillë, ose të paktën a duhet rishikuar ai. Të dyja objektet përmenden për herë të parë 120 vjet pas vdekjes së

* Përkthyer në gjuhën shqipe nga Genc Lafë. Artikulli është botuar në: *Jahrbuch des Kunsthistorischen Museums Wien*, Band 10 (2008), pp. 150-159.

Heroit shqiptar në inventarin e Ambrasit të vitit 1593¹ si Georgen Scanderbegg Helmlin vnnnd zway Schwerter (*përkrenarja e Gjergj Kastriotit dhe dy shpata*); në inventarin e vitit 1596 ato dokumentohen me këto fjalë²:

Geörg Schcanderbeeg.

Ain weszß helbmlin, mit vergulden raiffen, darauf ain vergulter gais khopf, mit seinen hörnern, und zwai schwerter. Daz aine in ainer lidern schaiden, welches vonwegen seiner schwere und, das man die masen von dem bluet noch daran sicht, für das recht geschickht worden und gehalten würdt, dzs ander in ainer sammeten schaidn, hat man auch under des Schcanderbeges namen verehrt³.

Pak më vonë përkrenarja dhe shpata botohen në *Armamentarium Heroicum*, së bashku me portretin e tij shtatplotë. Ky inventar i ilustruar me gravura u botua nga Jakob Schrenck von Notzing, sekretari i arkidukës Ferdinand II së pari në latinisht më 1601 e më pas në gjermanisht më 1603. Krahas çdo objekti botohet edhe jetëshkrimi (Vita) i zotëruesit. Në këtë rast ajo fillon me fjalët: *Georg Castriota genannt Scanderbeg Fürst in Albania* “Gjergj Kastrioti i quajturi Skënderbe Princ në Shqipëri”⁴. Cili ishte Gjergj Kastrioti dhe përse zuri vend në Dhomën e Armëve të Heronjve (Heldenrüstkammer) të arkidukës Ferdinand të Tirolit?

¹LHOTSKY 1945: 197.

²ZIMMERMANN 1888, CCXXII, Reg. 5556.

³“*Një përkrenare e vogël e bardhë me rrathë të praruar, mbi të cilat është një kokë dhie me brirë e praruar dhe dy shpata. Njëra syresh është në një mill të lëkurtë; nga pesha e saj dhe nga gjurmët e gjakut që ende shihen në të mendohet të jetë e mirëfilltë. Tjetrën, në një mill të kadifenjtë, e kanë adhuruar po ashtu nën emrin e Skënderbeut*”.

⁴Schrenck von Notzing 1981: Tab. 18.

Gjergj Kastrioti lindi rreth vitit 1403. Familja e tij bënte pjesë në fisnikërinë e vogël shqiptare dhe kishte zotërimë në luginën e Matit. I ati, Ivan Kastrioti, u shtrëngua të njihte sipëraninë e sulltanit osman Bajazit I, por i ndërpreu marrëdhëniet e vasalitetit pas betejës së Ankarasë (1402). Ai i zgjeroi zotërimet e tij deri në bregdetin e Adriatikut dhe u përpoq të afrohej me venedikasin, por nën trysninë osmane u shtrëngua të njihte sërish sipëraninë turke dhe të dërgonte të birin si peng në oborrin osman në Adrianopojë, ku ky i fundit më 1423 u bë pazh dhe mori arsimim ushtarak. Gjergj Kastrioti u kthye në mysliman dhe mori emrin Iskënder (Aleksandër). Si oficer i lartë osman në vitet '30 të shekullit të 15-të mbajti funksione të ndryshme administrative në Shqipërinë e pushtuar nga turqit.

Gjatë ofensivës së suksesshme të ushtrisë hungareze të udhëhequr nga Janosh Huniadi në nëntor 1443 Skënderbeu së bashku me trupat e tij shqiptare dezertoi dhe mori kështjellën shqiptare të Krujës. Ky ishte fillimi i një kryengritjeje të re shqiptare kundër turqve. Për t'u bërë ballë më mirë turqve Skënderbeu u bë kryekomandant i Lidhjes Shqiptare, e cila u formua në Lezhë, në një kuvend të fisnikërisë shqiptare, më 2 mars 1444. Me ushtrinë e tij të re Skënderbeu mundi të shtjerë në dorë kështjellat osmane në Shqipërinë e Mesme dhe të zmbropsë shumë sulme turke. Më 1450 një ushtri turke e komanduar nga vetë sulltan Murati II rrethoi pa sukses kështjellën kryesore të Skënderbeut, Krujën. Kjo fitore kundër turqve ngjalli mrekullim në mbarë Perëndimin e krishterë dhe Gjergj Kastrioti u nderua nga papa Nikolla V si "Athleta Christi", Ushtari i Parë i Jezu Krishtit dhe si hero kryqtar. Duke parë se pushteti i tij po rritej me shpejtësi Alfonsi V i Napolit më 26 mars 1451 nënshkroi një aleancë me Skënderbeun⁵. Ky i

⁵BARTL 1998: 117-119.

fundit u shpall vasal i Napolit dhe në këmbim siguroi mbështetje financiare dhe ushtarake.

Në strategjinë e papës Piu II, të fronëzuar më 1458, Shqipëria kishte një vend qendror: këtu do të zbriste ushtria e kryqtarëve, e cila do të bashkohej me trupat e Skënderbeut. Piu II e quajti Skënderbeun “mburojë e Krishterimit”. Që më 1459 Venediku kishte kërkuar pranë Papës përfshirjen e Skënderbeut në një ofensivë kundër turqve dhe kishte propozuar dërgimin e një ushtrie italiane prej 10.000 trupash në Shqipëri⁶. Një përkrahës i rëndësishëm i idesë së kryqëzatës në Shqipëri ishte Pal Engjëlli, peshkop i Durrësit, i cili donte ta bënte Skënderbeun mbret të Shqipërisë. Gjergj Kastrioti do të kurorëzohej mbret i Epirit dhe i Maqedonisë, si pasues i Pirros së Epirit dhe i Aleksandrit të Madh, i cili ishte epirot nga e ëma. Në vitet 164-166 ishin bërë plane për këtë kurorëzim⁷. Vdekja e Piut II në Ankonë dhe si rrjedhojë dështimi i kryqëzatës, si edhe rrënimi i pushtetit të Skënderbeut në Shqipërinë e Mesme nën goditjet e ofensivës së fuqishme të sulltanit osman Mehmet II sollën edhe rënien e princit shqiptar. I shtrënguar të luftojë gjithnjë e më tepër në mbrojtje dhe i varur nga ndihma e Venedikut, Gjergj Kastrioti vdiq në Lezhë më 17 janar, pa mundur të kurorëzohet. Pas vdekjes familja e tij u shpërngul në Italinë e jugut.

Këto janë faktet historike mbi heroin Gjergj Kastrioti. Arkiduka Ferdinand II i Tirolit, i cili donte të mblidhte në dhomën e tij të armëve të heronjve në Ambras të gjithë udhëheqësit e mëdhenj ushtarakë të shekujve të 15-të dhe 16-të, nuk mund të linte mënjane objektet që kishin të bënin me këtë hero të madh të luftës së të krishterëve kundër turqve. Ai vetë, pas një fushate kundër turqve në Hungari më 1556 u ndje si hero

⁶SCHMITT 2005: 138 e vijim.

⁷SCHMITT 2005: 142-144.

në këtë luftë. Madje u cilësua edhe vetë si i tillë prej dy papëve, Piut V dhe Gregorit XIII. Nga viti 1578 deri më 1588 dëshmohep përpjekje të arkidukës për të gjetur relika të Gjergj Kastriotit. Këto përpjekje ndoshta kanë vijuar më gjatë, sepse përkrenarja që përmendet këtu, një përkrenare-kurorë, dëshmohep vetëm në Inventarin e dhomës së armëve të Ambrasit të vitit 1593 dhe është riprodhuar në *Armamentarium Heroicum* të Schrenck von Notzingut. Sendet e përmendura në inventar janë blerë nga Ferdinandi në Itali, ka të ngjarë në Urbino, dhe i kanë kaluar në zotërim atij ndoshta përmes të afërmeve të vet italianë⁸. Ndërmjet kësaj kohe dhe vdekjes së Skënderbeut kanë kaluar mbi 120 vjet dhe natyrshëm shtrohet pyetja nëse këto objekte, që arkiduka Ferdinand mundi të gjejë për dhomën e tij të armëve të heronjve, kanë qenë vërtet të Heroit shqiptar. Mbi vendndodhjen e tyre nuk kemi asnjë të dhënë që nga ikja e familjes së Skënderbeut në Itali e deri në përmendjen e tyre në Inventarin e Ambrasit. Nëse këto objekte, përkrenarja me numër inventari A 127 dhe shpata me numër inventari A 550, shqyrtohen sot me kujdes, bien në sy disa mospërputhje të dukshme.

Përkrenarja përbëhet nga një kupë, e cila formohet nga mbetjet e një përkrenareje italiane. Ana e poshtme dhe pjesa e pasme që mbron zverkun janë sharruar ose prerë me daltë aq trashë saqë janë formuar plasaritje dhe çarje. Për këtë arsye përkrenarja nuk mund të mbahet mbi kokë, sepse do të binte menjëherë. Plasaritjet dhe çarjet tregojnë që shkëputja e asaj pjese të përkrenares është bërë pas kalitjes së metalit. Pra përkrenarja nuk mund të jetë konceptuar në këtë formë që në fillim. Shtrohet pyetja a do ta kishte pranuar princi Gjergj Kastrioti një punim të tillë me vlerë kaq të ulët dhe a do të mund

⁸THOMAS & GAMBER 1976: 61.

të përdorte si kurorë një send të tillë papa Piu II, i cili përgatiste kurorëzimin e Kastriotit. Kur një përkrenare luksoze përdorej si përkrenare-kurorë zakonisht nuk merrej një përkrenare e përdorur, por farkëtohej rishtas një përkrenare e re për atë qëllim, për më tepër në këtë rast, kur kurorëzimi i Gjergj Kastriotit ishte planifikuar prej kohësh, edhe pse nuk u krye kurrë.

Rrethi ballor që i është ngjitur përkrenares ka 6 rozeta, vetëm njëra prej të cilave, ajo e zverkut, është e shekullit të 15-të. Në mbishkrimin mbi këtë rreth, “IN/PE/RA/TO/RE/BT” janë përdorur shkronja të vogla (minuskula) gotike. Mbyllja e sipërme e shkronjës T të shkrimit *teksturë* (*Textura*) gotike zakonisht zgjatet pak përtej vijës vertikale, ndërsa tek T-ja e përdorur në këtë mbishkrim ajo zgjatet shumë më tepër. Kjo vijë e gjatë mbi vijën tërthore të T-së është një shenjë e shkrimit *frakturë* (*Fraktur*), i cili u zhvillua nga shkrimi gotik me cepa të mprehta. Shkruesi i kancelarisë Wolfgang Spitzweg e zhvilloi *frakturën* nga elemente të *teksturës* (*Textura*) gotike për dy libra mësimorë për Maximilianin I. Ky shkrim u përdor për herë të parë në kancelari rreth 1500-ës dhe vetëm më 1517 përdor në formën e tij përfundimtare në librin e njohur *Theuerdank*, shkruar për perandorin Maximilian I. Formën përfundimtare të shkrimit *frakturë* e konceptoi sekretari perandorak Vinzenz Rockner. Duke qenë se të dyja shkronjat T shfaqen në formën e zhvilluar të *frakturës*, mbishkrimi mund të jetë gdhendur vetëm pas vitit 1517, pra rreth 50 vjet pas datës së hamendësuar të prodhimit të përkrenares luksoze për Gjergj Kastriotin (i cili kishte vdekur më 1468).

Zbukurimi mbi përkrenare ka formën e një koke dhe. Kjo ishte emblema luftarake e princit të lashtë të Epirit, por brirët e dhisë përfaqësojnë edhe Aleksandrin e Madh, i cili në Kuran

emërtohet si “ai me dy brirët”⁹. Koka e dhisë është bërë nga një fletë bakri e rrahur, e gdhendur dhe e praruar. Zgavrat e syve që sot janë të zbrazëta duhet të kenë qenë të mbushura me material me ngjyrë. Koka e punuar me shumë mund nuk është elegante dhe është vendosur mbi një pllakë bakri me anë të praruara e me një shirit zambakësh në anë. Ky i fundit është thyer në pjesën më të madhe të saj dhe pllaka e bakrit në të vërtetë nuk i bën përkrenares. Vrima e kreshtës së përkrenares fillimisht shërbente për të vendosur mbajtësen e kreshtës. Edhe një herë është vështirë të besohet që një përkrenare-kurorë të jetë bërë me pjesë kaq të ndryshme që lidhen keq me njëra-tjetrën.

Këtu shtrohet pyetja se si duhen vlerësuar pjesët e veçanta. Mundësia që një përkrenare e prerë në mënyrë të tillë të jetë përdorur për kurorëzimin e Gjergj Kastriotit sipas meje duhet përjashtuar. Po ashtu edhe mbishkrimi nuk mund të jetë menduar për princin shqiptar, sepse ai me siguri është i shekullit të 16-të. Edhe titulli “Imperator” nuk shkon – më tepër do të pritej këtu “Rex”, lat. *mbret*, ose gr. “Basileus” *mbret* me shkronja të greqishtes. Edhe pllaka e bakrit me shiritin e zambakëve është një e dhënë aspak bindëse; ajo është punuar relativisht thjesht dhe nuk përshtatet në formë me kokën e dhisë, pra duhet të jetë shtuar më vonë. Ndërsa koka e dhisë është e një cilësie të shkëlqyer. Por një zbukurim i tillë i përkrenares në kontekstin italian nuk lidhet me një hero të madh të luftës kundër turqve – këtë rol do ta luante më mirë një kokë luani. Ndërsa në rrethin kulturor të Shqipërisë së Mesme, nën ndikimin grek, koka e dhisë luante një rol të rëndësishëm. Ajo është simboli i Aleksandrit të Madh dhe i mbretit të Epirit, Pirros. Vallë ishte koka e dhisë një pjesë origjinale e kurorës që do të vinte mbi kokë Gjergj Kastrioti? Nën ndikimin e arkiveshkvit të

⁹DAUM 1998: 16.

Durrësit, Pal Engjëllit, me formim humanist, dhe të elitës katolike rreth Skënderbeut në Shqipëri mëtohej, përmes propagandimit të Skënderbeut si një Aleksandër i ri, për ta paraqitur shtetin shqiptar që do të formohej si të barabartë me shtetet italiane.

Arkiduka Ferdinand duhet të ketë ditur për ekzistencën e këtyre mëtimeve për një mbretëri shqiptare. Kështu Jakob Schrenck von Notzing në botimin gjermanisht të jetëshkrimit të Skënderbeut në *Armamentarium Heroicum* bën fjalë për synimet e Gjergj Kastriotit për t'u kurorëzuar në Romë¹⁰:

Folgendts râysete Scanderbeg gen Rom/unnd brachte mit vilen Argumenten bey/wellichermassen die grosse not erforderte daß der Bapst die Christliche Fürsten vereinige/und wider den Türggen auffbringe/erbott sich auch das Christliche Heer selbst zu füren. Der Bapst war zwar willens ihn nit allein uber ganz Albanien/sonder auch Macedonien zum König zu machen/ weil er Scanderbeg aber durch der christlichen Potentaten inheimischen Hass und zancken dieser hoffnung beraubt wurde/kehrte er widerumb inn sein Vatterlandt/verrichtete darauff nichts weiters namhaftes oder das seinem vorgen lob gleich gewest wäre¹¹.

¹⁰SCHRENCK VON NOTZING 1981: Tab. 18.

¹¹ “Në vijim Skënderbeu udhëtoi drejt Romës dhe argumentoi se gjendja e rëndë bënte të nevojshme një lidhje të princave të krishterë kundër turqve nën drejtimin e papës. Ai vetë u ofrua ta udhëhiqte ushtrinë e krishterë. Papa synonte ta bënte jo vetëm mbret të Shqipërisë por edhe të Maqedonisë. Por Skënderbeut iu pre kjo shpresë për shkak të armiqësisë dhe grindjeve ndërmjet princave të krishterë. Ai u kthye në atdhe e më pas nuk kreu bëma të mëdha, por as edhe bëma që të ishin në lartësinë e emrit të tij të deriatëhershëm”.

Si rrjedhim ka vetëm dy shpjegime, ndërsa një qartësim përfundimtar i kësaj çështjeje është shumë i vështirë. Një mundësi është që koka e dhisë së përkrenares së Vjenës të ketë qenë vërtet një pjesë e kurorës së planifikuar të Skënderbeut. Kjo kurorë pas gjasave nuk u prodhua kurrë, sepse pas vdekjes së papritur të Piut II në Ankonë më 1464 ideja e kryqëzatës dhe krijimit të një mbretërie të Shqipërisë dhe Maqedonisë dështoi. Zbukurimi i përkrenares ka të ngjarë të ketë mbijetuar në Itali në rrethin e familjes Kastrioti dhe t'u jetë mbërthyer pjesëve të tjera për arkidukën Ferdinand. Mundësia tjetër është që, duke mbajtur parasysh përmasat historike dhe përmbajtjen simbolike të kokës së dhisë, të jetë gjetur një e tillë nga shekulli i 15-të dhe t'u jetë mbërthyer pjesëve të tjera të përkrenares. Por duke mbajtur parasysh peshën e pakët simbolike që ka koka e dhisë në rrethin kulturor të Europës perëndimore dhe jugore unë prirem të mendoj se kjo ka qenë vërtet një pjesë e kurorës së planifikuar për Skënderbeun. Megjithatë, ka shumë të ngjarë që kjo çështje të mos gjejë një zgjidhje përfundimtare.

Bashkë me përkrenaren Ferdinandi II i Tirolit mori edhe dy shpata, të cilat në Inventarin e Ambrasit të vitit 1596 njihen si të Skënderbeut. Njëra duhet të ketë qenë një shpatë e shkurtër e hollë armaturëshpuese dhe sot ka humbur. Tjetra ka një teh të shekullit të 15-të me një dorezë të mëvonshme të llojit turk¹². Kjo shpatë ka edhe një mill të mëvonshëm prej lëkure të zezë. Është vështirë të besohet se arkiduka ka shtënë në dorë relika të princit shqiptar, sepse një sërë shkaqesh thelbësore dhe formale lënë të mendohet se këtu kemi të bëjmë me një falsifikim.

Shpata është vërtet e shekullit të 15-të, por ka një mbishkrim të palexueshëm në arabisht, gjë që tregon se është prodhuar nga një farkëtar që nuk e njihnte arabishten. Gjergj Kastrioti në rininë

¹²THOMAS & GAMBER 1976: 62.

e tij u arsimua në shkollën e pallatit osman dhe natyrisht dinte të lexonte e të shkruante në arabisht, persisht dhe turqisht. Një njeri me një formim të tillë të thellë, madje edhe me arsimim letrar si Gjergj Kastrioti, vështirë të kishte pranuar një shpatë me mbishkrim të palexueshëm.

Forma e kësaj shpate është shumë e pazakontë. Ajo nuk është as një jatagan turk, as një shpatë europiane e shekullit të 15-të. Nga tehu dhe doreza ngjan me shpatën e kalifit al-Musta'sim, që datohet përpara vitit 1258¹³ dhe me të ashtuquajturën shpatë të Osmanit; të dyja sot ndodhen në muzeun e Topkapisë në Stamboll¹⁴. Shpata e kalifit al-Musta'sim dëshmohet në Egjipt në shekullin e 15-të dhe u soll në Topkapi Saraj pas fitores së sulltan Selimit I mbi mamlukët më 1517, pra rreth 50 vjet pas vdekjes së Skënderbeut. E ashtuquajtura shpatë e Osmanit është prodhuar vetëm në shekullin e 18-të, sipas gjedheve më të vjetra. Ajo përdorej në ceremonitë e fronëzimit të sulltanëve osmanë.

Vallë arkidukës Ferdinand II në Italinë e shekullit të 16-të kanë dashur t'i dhuronin një shpatë kurorëzimi, e cila të lidhej me zakonet e Perandorisë Osmane? Vështirë të besohet që Gjergj Kastrioti për kurorëzimin e tij si mbret i krishterë i Shqipërisë të përdorte një shpatë të zbukuruar me aludime të tilla. Propaganda për kurorëzimin e mundshëm të Skënderbeut lidhej me heroin e lashtësisë Aleksandrin e Madh. Për këtë arsye do të ishte tepër e habitshme që për këtë kurorëzim të përdorej një shpatë që sillte ndër mend kundërshtarin e madh të Kastriotit, sulltanin osman. Por në fund të shekullit të 16-të ky kontekst propagandistik ishte zbehur tashmë. Nga tregimet e të dërguarve italianë në oborrin osman dihej se si ishte një shpatë

¹³ROGERS 1987: 206.

¹⁴Khs. ZAKY 1979: 206.

Përkrenarja dhe shpata e Gjergj Kastriotit, të quajtur Skënderbe / L'elmo e la spada di Giorgio Castriota detto Scanderbeg

ceremoniale kurorëzimi në Perandorinë Osmane, së cilës atëherë i përkiste edhe Shqipëria. A ka përdorur këtë dije falsifikuesi i mundshëm?

Si shpata ashtu edhe përkrenarja duhet të jenë prodhuar në fund të shekullit të 16-të. Këtu nuk duhet përjashtuar fakti se koka e dhisë i ka përkatur vërtet Gjergj Kastriotit. Tregtari i tyre, që ishte njëkohësisht edhe falsifikues, me sa duket është përpjekur që me pjesë të veçanta, të cilat mund të vinin nga mjedisi i afërt dhe i largët rreth princit shqiptar, të prodhonte një *pasticcio* që të njihej si e heroit shqiptar, e cila më pas iu shit Ferdinandit II si pjesë origjinale e armëve të Ngadhënjyesit mbi turqit, aq shumë të çmuar prej tij.



*L'elmo e la spada di Giorgio Castriota detto Scanderbeg**

Nell'armeria imperiale del *Kunsthistorisches Museum* di Vienna si trovano due oggetti che a partire dal XVI sec. vengono attribuiti all'eroe albanese Giorgio Castriota detto Scanderbeg (1403-1468). Si pone il problema di quanto sia corretta questa attribuzione e se, almeno in parte, debba essere rivista. I due oggetti vengono menzionati¹ per la prima volta 120 anni dopo la morte dell'eroe albanese nell'inventario di Ambras del 1593 come *Georgen Scanderbegg Helmlin vnnd zway Schwerter* ('l'elmo di Giorgio Castriota Scanderbeg e due spade') e sono documentati nell'inventario del 1596 con le seguenti parole²:

Geörg Schcanderbeeg.

Ain weszß helbmlin, mit vergulden raiffen, darauf ain vergulter gais khopf, mit seinen hörnern, und zwai schwerter. Daz aine in ainer lidern schaiden, welches vonwegen seiner schwere und, das man die masen von dem bluet noch daran sicht, für das recht geschickht worden und gehalten würdt, dzs ander in ainer sammeten schaidn, hat man auch under des Schcanderbeges namen verehrt³.

* Traduzione dal tedesco di Monica Genesin.

¹ LHOTSKY 1945: 197.

² ZIMMERMANN 1888, CCXXII, Reg. 5556.

³ "Un piccolo elmo bianco con nastri dorati sul quale poggia una testa dorata di capra con le sue corna e due spade, una delle quali si trova in una guaina di pelle. Quest'ultima per il suo peso e per il fatto che ancora sono visibili in essa tracce di sangue si considera autentica. L'altra spada in una guaina di velluto fu ammirata per la sua connessione col nome di Scanderbeg".

In seguito, nell'*Armamentarium Heroicum* del 1601 sono menzionati l'elmo e la spada come oggetti di Giorgio Castriota insieme al suo ritratto a figura intera. Questo repertorio iconografico illustrato in incisioni fu pubblicato in un'edizione in latino nel 1610 e in tedesco nel 1603 dal segretario dell'Arciduca Ferdinando, Jakob Schrenck von Notzing. In quest'opera accanto all'oggetto si trova puntualmente la vita del possessore. La vita compilata in tedesco inizia con le parole *Georg Castriota genannt Scanderbeg Fürst in Albania*⁴.

Chi era Giorgio Castriota e perché lo incontriamo nell'Armeria degli Eroi dell'Arciduca Ferdinando del Tirolo?

Giorgio Castriota nacque intorno al 1403. La sua famiglia che apparteneva alla piccola nobiltà locale, aveva possedimenti nella valle del fiume Mat. Suo padre, Ivan Castriota, dovette riconoscere la sovranità del sultano ottomano Bayezid I, ruppe tuttavia il rapporto di vassallaggio di nuovo dopo la disfatta di Ankara (1402). Egli ampliò il suo dominio fino all'Adriatico e cercò appoggio presso i veneziani; in seguito alla pressione ottomana dovette nuovamente riconoscere la sovranità turca e inviare suo figlio Giorgio come ostaggio alla corte ottomana ad Adrianopoli dove questi, dopo il 1423, assunse il ruolo di paggio e conseguì un'educazione militare. Giorgio Castriota si convertì all'Islam e prese il nome di Iskender (Alessandro). Negli anni intorno al 1430 come ufficiale ottomano di alto rango assunse diversi ruoli nel sistema amministrativo dell'Albania turca.

In seguito alla vittoriosa offensiva dell'esercito ungherese guidato da Giovanni Hunyadi, disertò nel novembre del 1443 con le sue truppe albanesi e si impossessò della fortezza albanese di Kruja. Quest'occupazione segnò l'inizio di una nuova ribellione albanese contro i turchi. Per organizzare nella maniera migliore

⁴ SCHRENCK VON NOTZING 1981: Tav. 18.

l'offensiva contro i turchi, Scanderbeg divenne comandante in capo della Lega Albanese che fu formata il 2 marzo del 1444 ad Alessio (Lezha) in occasione di un'assemblea della nobiltà albanese. Col suo nuovo esercito riuscì a conquistare le fortezze turche dell'Albania centrale e a respingere numerosi attacchi turchi. Nel 1450 un esercito turco sotto la guida personale del Sultano Murad II pose invano l'assedio a Kruja, la principale fortezza di Scanderbeg. Questa vittoria suscitò ammirazione in tutta l'Europa cristiana e Giorgio Castriota venne acclamato dal papa Niccolò V *Athleta Christi*, primo soldato di Gesù Cristo, eroe delle crociate. Dal momento che egli stava divenendo una potenza significativamente crescente dall'altra parte dell'Adriatico, il 26 marzo del 1451 il re Alfonso V di Napoli strinse con lui un'alleanza⁵. Divenne un vassallo di Napoli e, in conseguenza di ciò, ottenne appoggio militare e finanziario. Nella strategia del papa Pio II, salito al trono pontificio nel 1458, l'Albania giocava un ruolo centrale. Qui doveva arrivare l'esercito dei crociati per riunirsi alle truppe di Scanderbeg. Pio II chiamò Scanderbeg lo scudo della Cristianità. Già nel 1459 Venezia aveva proposto al papa l'inclusione di Scanderbeg in una guerra di attacco e l'invio di un forte esercito italiano composto da 10.000 uomini⁶. Un importante sostenitore in Albania dell'idea di una crociata era Paulus Angelus, arcivescovo di Durazzo, che voleva Scanderbeg come re d'Albania, sostenendo in particolare il suo ruolo di successore di Alessandro Magno e del re d'Epiro. Come successore di Pirro d'Epiro e di Alessandro Magno, che era epirota da parte di madre, Giorgio Castriota avrebbe dovuto diventare re d'Epiro e di Macedonia. Nel periodo che va dal 1464 al 1446 vi furono progetti per

⁵ BARTL 1998: 117-119.

⁶ SCHMITT 2005: 138 ss.

l'incoronazione⁷. La morte del papa Pio II ad Ancona, il conseguente fallimento di questa crociata e il crollo della potenza di Scanderbeg nell'Albania centrale per la rafforzata offensiva del Sultano ottomano Mehmed II, portò tuttavia al decadimento del potere dei principi albanesi. Giorgio Castriota sempre più sulla difensiva e in dipendenza dall'aiuto di Venezia, morì il 17 gennaio 1468 ad Alessio (Lezha) senza potere giungere all'incoronazione. Dopo la sua morte, la famiglia fuggì nell'Italia meridionale.

Questa è la versione fornita dalla vita dell'eroe Giorgio Castriota. L'Arciduca del Tirolo, che nella sua Armeria degli Eroi voleva circondarsi di tutti i condottieri del XV e XVI sec. non poteva rinunciare a oggetti che erano in rapporto con questo campione della fede, in virtù delle illustri imprese compiute dal principe albanese contro i turchi. Per l'Arciduca Ferdinando II, che si sentiva un campione nella lotta contro i turchi per avere partecipato a una campagna militare nel 1556 in Ungheria e per essere stato salutato come eroe da due papi, Pio V e Gregorio XII, era una assoluta necessità il possesso di oggetti che potessero essere messi in relazione con questo grande eroe della lotta cristiana contro i turchi. Dal 1578 fino al 1588 sono documentati i tentativi dell'Arciduca di conseguire oggetti ricordo di Giorgio Castriota. Forse i suoi tentativi ebbero luogo in un periodo più lungo, poiché questo elmo col rango di una corona venne menzionato per la prima volta nel 1593 nell'inventario dell'armeria di Ambras e nel 1601/1603 fu riprodotto nell'*Armamentarium Heroicum* di Schrenck von Notzing. Gli oggetti indicati nell'inventario furono conseguiti da Ferdinando in Italia, probabilmente a Urbino, forse attraverso la mediazione

⁷ SCHMITT 2005: 142-144.

di parenti italiani dell'Arciduca⁸. Tra l'acquisizione degli oggetti e la morte di Scanderbeg erano trascorsi più di 120 anni, di conseguenza si pone il problema di stabilire se gli oggetti ottenuti dall'Arciduca per la sua armeria fossero stati realmente in possesso dell'eroe albanese, Giorgio Castriota. Non abbiamo alcuna indicazione riguardo a dove si trovassero gli oggetti sopra citati, l'elmo e la spada, dalla fuga della famiglia in Italia alla loro menzione nell'inventario di Ambras.

Se si analizzano con precisione gli oggetti che oggi possediamo, l'elmo con numero d'inventario A127 e la spada con numero di inventario A550, colpiscono alcune inconseguenze. L'elmo è costituito da un coppo che è, in realtà, il residuo di una celata di fabbricazione italiana. Il bordo inferiore e il paracollo dell'elmo sono stati segati o scalpellati in maniera così grezza che si sono formate crepe e fratture. Per questo motivo l'elmo non può più essere indossato perché potrebbe cadere. Le crepe e le fratture indicano che la rimozione di parti dell'elmo è stata compiuta soltanto dopo che il metallo era già stato temprato. L'elmo non può essere stato concepito originariamente in questa forma. È dubbio che un principe come Giorgio Castriota abbia potuto accettare un lavoro così maldestro, o che un papa, Pio II, che aveva preparato la possibile incoronazione del Castriota, abbia voluto utilizzare come corona un manufatto di così scarsa qualità. Per un elmo di gala che doveva assumere il ruolo di una corona non si utilizzava solitamente nessun elmo già usato in passate occasioni, ma veniva forgiato un modello appropriato. Tanto più che la possibile incoronazione di Giorgio Castriota a Re dell'Epiro, pur progettata da molto tempo, non aveva mai avuto luogo.

⁸ THOMAS & GAMBER 1976: 61.

La fascia di rame adattata all'elmo consta di 6 rosette delle quali soltanto una, quella sulla nuca, può essere attribuita al XV sec. Nell'iscrizione della fascia IN/PE/RA/TO/RE/BT è utilizzato il gotico minuscolo. La chiusura della lettera T della *textura* gotica di solito supera di poco l'asta, mentre l'asta della T utilizzata nell'iscrizione della fascia va chiaramente oltre l'asta. Questo lungo tratto sopra l'asta trasversale della T è un'indicazione della forma di scrittura denominata *Fraktur* che si sviluppò dalla spigolosa scrittura gotica. Lo scrivano della cancelleria Wolfgang Spitzweg ha sviluppato la *Fraktur* da elementi della *Textura* per due libri di testo destinati a Massimiliano. Intorno al 1500 essa fu utilizzata per la prima volta nella cancelleria e solo nel 1517 fu usata nella sua forma più sviluppata nel noto libro *Theuerdank*, scritto per il Kaiser Massimiliano I. Il segretario del Kaiser, Vincenz Röcker, concepì la scrittura *Fraktura* nella forma evoluta. Dal momento che le due lettere T nell'iscrizione attestano la conoscenza della *Fraktura* nella forma evoluta, questa iscrizione nella fascia può risalire a un periodo successivo al 1517, quindi circa 50 anni dopo la datazione stabilita per l'elmo di gala di Giorgio Castriota (quest'ultimo morì nel 1468). Il cimiero ha la forma di una testa di capra. La testa di capra costituiva l'insegna dei principi di Epiro dell'antica Grecia, d'altra parte le corna di capra rappresentano il nome di Alessandro Magno. Egli è menzionato nel Corano come "quello con le due corna"⁹. La testa di capra venne preparata da una lastra di rame sbalzata, incisa e placcata d'oro. Le orbite oggi vuote erano certamente riempite con materiale colorato nel momento in cui fu realizzata la testa. La testa lavorata in modo dispendioso è appoggiata in modo privo di eleganza a una placca di rame con un orlo

⁹ DAUM 1998: 16.

ornamentale dorato e un bordo di gigli realizzato in modo grossolano. Il bordo di gigli è in gran parte spezzato. La placca di rame non si adatta in realtà all'elmo. Il foro del cimiero nell'elmo serviva originariamente per fissare un sostegno. Anche in questo caso è abbastanza improbabile che un copricapo di rango reale potesse essere costituito da pezzi così diversi e che male si adattavano tra loro.

Si pone la questione di come potere valutare i singoli pezzi. A mio avviso si deve escludere che un bacinetto tagliato potesse servire all'incoronazione di Giorgio Castriota. Oltre a ciò l'iscrizione non può essere stata pensata per il Principe di Albania. Sicuramente essa risale infatti al XVI sec. e anche il titolo di imperatore non si addice, essendo preferibile il titolo di *Rex* o di *Basileus*, scritto in lettere greche. Oltre a ciò la placca di rame col bordo di gigli non è convincente, poiché è stata fabbricata in maniera abbastanza grezza senza potersi adattare nella sua forma alla testa di capra; di conseguenza essa potrebbe costituire un accessorio successivo. Una testa di capra nel contesto culturale italiano non forma la decorazione di un elmo che è in connessione con un grande eroe della lotta contro i turchi. In questo caso sarebbe più appropriata la testa di leone. Nell'ambito culturale dell'Albania centrale influenzato dalla Grecia, la testa di capra gioca invece un ruolo importante: è il simbolo di Alessandro Magno e del re epirota Pirro. Forse la testa di capra costituiva un pezzo originale della progettata corona di Giorgio Castriota? Sotto l'influenza dell'arcivescovo di Durazzo Paulus Angelus, formatosi nella cultura umanistica, e della élite cattolica intorno a Scanderbeg, si verificò in Albania il tentativo di esplicitare la pretesa di un'equiparazione del nascente stato albanese con gli stati italiani attraverso la propaganda del mito di Scanderbeg. Anche l'Arciduca Ferdinando poteva

essere a conoscenza di questa pretesa di un regno albanese. Così scrive Jakob Schrenck von Notzing nella versione tedesca dell'*Armamentarium Heroicum* relativo alla vita di Scanderbeg e ai progetti di incoronazione di Giorgio Castriota a Roma¹⁰:

Folgendts râysete Scanderbeg gen Rom/unnd brachte mit vilen Argumenten bey/wellichermassen die grosse not erforderte daß der Bapst die Christliche Fürsten vereinige/und wider den Türggen auffbringe/erbott sich auch das Christliche Heer selbst zu füren. Der Bapst war zwar willens ihn nit allein uber ganz Albanien/sonder auch Macedonien zum König zu machen/ weil er Scanderbeg aber durch der christlichen Potentaten inheimischen Hass und zancken dieser hoffnung beraubt wurde/kehrte er widerumb inn sein Vatterlandt/verrichtete darauff nichts weiters namhaftes oder das seinem vorgen lob gleich gewest wäre¹¹.

Di conseguenza vi sono due opzioni e solo con difficoltà si può scegliere definitivamente in favore dell'una o dell'altra. In base alla prima opzione si può ipotizzare che la testa di capra dell'elmo di Vienna realmente costituisca una parte della progettata corona di Scanderbeg. Questa corona non è mai stata probabilmente completata, poiché con l'improvvisa morte di Pio II ad Ancona nel 1466 naufragarono l'idea della crociata e i

¹⁰ SCHRENCK VON NOTZING 1981: Tav. 18.

¹¹ “*In seguito Scanderbeg viaggiò alla volta di Roma e portò molti argomenti in favore di un'alleanza dei principi cristiani contro i Turchi sotto il patrocinio del Papa. Egli si offriva come comandante di questo esercito. Il Papa intendeva renderlo re non solo d'Albania, ma anche di Macedonia. Ma Scanderbeg a causa dell'ostilità e delle discordie interne dei principi cristiani venne privato di questa speranza e fece ritorno nella sua patria. Successivamente non compì più imprese notevoli e neanche imprese che sarebbero state all'altezza della sua precedente fama*”.

progetti relativi alla creazione di un regno di Albania e Macedonia. Questo pezzo della corona sarebbe rimasto probabilmente in Italia nell'ambito della famiglia Castriota e, in seguito, sarebbe stato combinato con i restanti pezzi dell'elmo per l'Arciduca Ferdinando. L'altra opzione è che invece una testa di capra sia stata forgiata nel XV sec. e, nella consapevolezza della dimensione storica e del contenuto simbolico di quest'oggetto, sia stata riunita alle parti restanti. In relazione alla limitata forza simbolica che la testa di capra possiede nell'ambito culturale europeo occidentale e meridionale, sono dell'avviso che si dovrebbe considerarla veramente una parte della progettata corona di Giorgio Castriota. Non è tuttavia possibile esprimere un giudizio definitivo sopra una tale questione.

Insieme all'elmo, Ferdinando II del Tirolo ottenne anche la "Spada di Scanderbeg", costituita da una lama del XV sec. e da un'impugnatura di modello turco appartenente a un periodo successivo¹². Alla spada appartiene anche una guaina di pelle nera, realizzata in un periodo successivo. È assai dubbio che l'Arciduca abbia veramente ottenuto gli oggetti originali del principe albanese. Probabilmente Ferdinando II ha ottenuto dei falsi. Una serie di elementi di carattere contenutistico e formale fanno dubitare dell'originalità anche di questo oggetto. La spada risale al XV sec., presenta tuttavia un'iscrizione non leggibile in lingua araba che indica un armaiolo che non padroneggiava l'arabo. Giorgio Castriota era stato allevato in gioventù nella scuola ottomana di palazzo e sapeva perfettamente leggere e scrivere in arabo, persiano e turco. Una persona come Giorgio Castriota che aveva goduto di un'educazione di così alto grado, anche a livello letterario, avrebbe difficilmente accettato una spada la cui

¹² THOMAS & GAMBER 1976: 62.

iscrizione non era leggibile. Nella sua forma esterna questa spada è alquanto insolita. Non si tratta né di una sciabola turca, né di una spada europea del XV sec. Si può tentare un confronto con spade che presentano lame e impugnature simili come la spada del califfo al-Musta'sim (Museo Topkapı Saray, Istanbul) precedente al 1258 d.C.¹³ e la cosiddetta spada di Osman, che si trova a Istanbul nel museo Topkapı Saray con numero di inventario 3775¹⁴. La spada del califfo al-Musta'sim è attestata nel XV sec. in Egitto e fu portata a Istanbul nel Topkapı Saray dopo la sconfitta del Sultano Selim I a opera dei Mamelucchi nel 1517, quindi circa 15 anni dopo la morte di Giorgio Castriota. La cosiddetta spada di Osman appartiene al XVIII sec., ma risale a modelli più antichi. Essa viene utilizzata nella cerimonia di insediamento al trono del sultano ottomano. Forse qualcuno nell'Italia del XVI sec. voleva forgiare per Ferdinando una spada per l'incoronazione così che fosse legata alle usanze dell'impero ottomano. È dubbio che Giorgio Castriota avesse utilizzato una spada che presentava queste allusioni per farsi re cristiano d'Albania. La propaganda intorno alla possibile incoronazione di Giorgio Castriota faceva riferimento all'antico eroe albanese e per questo motivo sarebbe stato molto sorprendente che si fosse servito di un oggetto che ricordava il sultano ottomano, ovvero il grande avversario del Castriota. Alla fine del XVI sec. questa connessione non era più così evidente. Sulla base delle esperienze degli inviati italiani alla corte ottomana, in Italia si conosceva come era fatta una spada cerimoniale di incoronazione dell'impero ottomano, impero cui apparteneva a quel tempo anche l'Albania. Forse il possibile falsario si è servito di questa conoscenza? La seconda spada

¹³ ROGERS 1987: 206.

¹⁴ Cfr. ZAKY 1979: 206.

registrata nell'inventario del 1596, probabilmente uno stocco, è oggi andata perduta.

La spada e l'elmo potrebbero essere una creazione del tardo XVI sec., anche se non si può escludere che la testa di capra sia veramente appartenuta a Giorgio Castriota. In questo caso il commerciante che nello stesso tempo era anche il falsario cercò di realizzare un pasticcio attribuibile all'eroe albanese, utilizzando pezzi non connessi tra loro che provenivano cronologicamente e spazialmente dall'ambiente vicino e lontano del principe albanese. Questo prodotto fu venduto all'Arciduca Ferdinando come oggetto originale in possesso del vincitore dei turchi, personaggio da lui molto ammirato.

Bibliografia

1. BARTL 1998: P. BARTL. "Albanien unter osmanischer Herrschaft", in: W. Daum (a cura di), *Albanien. Zwischen Kreuz und Halbmond*. München.
2. DAUM 1998: W. DAUM. "Skanderbeg", in: W. Daum (a cura di), *Albanien. Zwischen Kreuz und Halbmond*. München.
3. LHOTSKY 1945: A. LHOTSKY. *Festschrift des kunsthistorischen Museums zur Feier des fünfzigjährigen Bestandes. Zweiter Teil. Die Geschichte der Sammlungen. Erste Hälfte. Von den Anfängen bis zum Tode Kaisers Karls VI. 1740*. Wien.
4. ROGERS 1987: J. M. ROGERS (a cura di). *Topkapi Saray-Museum. Kleinodien. Herrsching am Hammersee*.
5. SCHMITT 2005: O. J. SCHMITT. "Skanderbeg als neuer Alexander. Antikerezeption im spätmittelalterlichen Albanien", in: F. Fuchs (a cura di), *Osmanische Expansion und europäischer Humanismus. Akten des interdisziplinären Symposions vom 29. und 30. Mai 2003 im Stadtmuseum Wiener Neustadt*. Wiesbaden.
6. SCHRENCK VON NOTZING 1981: J. SCHRENCK VON NOTZING. *Die Heldenrüstkammer* (a cura di B. Thomas). Osnabrück 1981.

Përkrenarja dhe shpata e Gjergj Kastriotit, të quajtur Skënderbe / L'elmo e la spada di Giorgio Castriota detto Scanderbeg

7. THOMAS & GAMBER 1976: B. THOMAS & O. GAMBER. *Katalog der Leibrüstkammer. I. Teil. Der Zeitraum von 500 bis 1530*. Wien.
8. ZAKY 1979: A. R. ZAKY. "Medieval Arab Arms", in: Robert Elgood (a cura di), *Islamic Arms and Armour*. London.
9. ZIMMERMANN 1888: H. ZIMMERMANN (a cura di). "Nachlaß-Inventar Erzherzog Ferdinands II. von 1596", in: *Jahrbuch der kunsthistorischen Sammlungen des des Allerhöchsten Kaiserhauses* 7. Wien, CCXXII, Reg. 5556.

